



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 132, datë 21.09.2019

**PËR LISTËN PËRFUNDIMTARE TË RENDITJES SË KANDIDATËVE PËR
GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, NË VENDIN VAKANT, VAKANCË E
PLOTË, TË SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229, të pikës 2 të nenit 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 68, 70 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi dëgjoi relatimin e relatorit, z. Fatri Islamaj dhe si e bisedoi çështjen, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, si më poshtë :

- | | |
|------------------------|-------------|
| 1) Arta Vorpsi | 89.642 Pikë |
| 2) Fiona Papajorgji | 88.785 Pikë |
| 3) Elsa Toska | 85.428 Pikë |
| 4) Marsida Xhaferllari | 82.000 Pikë |

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI

